



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.09.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit të datave 10, 11 dhe 12 shtator 2018.
2. Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar”. *(Komision për dhënie mendimi)*
3. Vlerësimi i meritës së kandidatëve dhe i përmbushjes së kushteve dhe kriterëve të kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Votimi i kandidatëve dhe miratimi i listës. *(Komision përgjegjës)*
4. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar (OFID), për projektin e punimeve për riparime emergjente të autostradës Tiranë –Elbasan”. *(Komision për dhënie mendimi)*

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Alket Hyseni, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina dhe Xhemal Qefalia.

Mungojnë:

Enkelejd Alibeaj, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi Tyli, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Tom Doshi dhe Silva Caka.

Të ftuar:

Damian Gjikhuri - Ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Gledian Llatja - Drejtor i Kabinetit në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Afrim Qendro - Drejtor i Përgjithshëm i ARRSH -së

Dardan Malaj - Këshilltar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Enea Karakaçi - Drejtor Juridik në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Erjon Luci - Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Tedi Bushaj - Specialist në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme meqenëse plotësohet kuorumi. Sot në rendin e ditës kemi 4 çështje.

Çështja e parë është miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit të datave 10, 11 dhe 12 shtator 2018.

Çështja e dytë është shqyrtimi nën për nen i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve të ndryshuar”. Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi dhe relator i këtij projektligji është kolegu Alket Hyseni.

Çështje e tretë është vlerësimi i meritës së kandidatëve dhe i përmbushjes së kriterëve të kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Koordinimin Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të ligjit nr. 115 të vitit 2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Është votimi i kandidatëve dhe miratimi i listës. Komisioni i Ligjeve është komision përgjegjës. Relatore është kolegja Klotilda Bushka.

Çështja e katërt është projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit OPEC për Zhvillimin Ndërkombëtar (OFID), për projektin e punimeve për riparime emergjente të autostradës Tiranë–Elbasan”. Komisioni i Ligjeve është komision për dhënie mendimi dhe relator është kolegu Adnor Shameti.

Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

A jeni dakord me procesverbalet e mbledhjet të komisionit të datave 10, 11 dhe 12 shtator 2018? A ka vërejtje? Nuk ka.

Miratoohen procesverbalet.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës.

Urdhëroni, zoti Hyseni!

Alket Hyseni – Faleminderit, zoti kryetar!

Kemi të bëjmë me një ligj, i cili nga pikëpamja teknike dhe ligjore është shumë i rëndësishëm. Duke qenë se ekspertët teknikë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në pamundësi për të qenë sot të pranishëm, sepse ndodhen jashtë vendit, unë si relator do të dëshiroja që ata të ishin këtu gjatë diskutimeve, prandaj i kërkoj komisionit që ta shtyjë këtë diskutim për ditët në vijim.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Hyseni!

Kolegë, a jeni dakord që ta shtyjë këtë projektligj për në mbledhjen e radhës? Dakord.

Atëherë, e shtyjme projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar” për mbledhjen e radhës, për të siguruar pjesëmarrjen e ekspertëve teknikë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilët kanë punuar me projektligjin.

Vazhdojmë me pikën tretë të rendit të ditës “Vlerësimi i meritës së kandidatëve dhe i përmbushjes së kriterëve dhe kushteve të kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Kemi votimin e kandidatëve dhe miratimi e listës.

Ashtu siç jeni në dijeni, në mbledhjen paraardhëse të Komisionit të Ligjeve ne patëm një seancë dëgjimore me 9 kandidatët e paraqitur në garë për t’u bërë pjesë e këtij komisioni të pavarur. Kandidatët në garë janë sipas renditjes: Andi Murataj, Artan Spahiu, Gëzim Allaraj, Ilir Kadiu, Irena Nino, Lindita Rusmajli, Sajmir Shehri, Sajmir Vishaj dhe Suzana Pasha Hoti.

Në fakt, dua t’ia jap fjalën relatores për të bërë një vlerësim të përgjithshëm për kandidatët. Më pas, sipas procedurës, do t’i hedhim në votim nominalisht secilin nga kandidatët. Sipas vendimit të Kuvendit, lista që do t’i paraqitet seancës plenare së bashku me raportin përkatës, duhet të ketë jo më pak se 7 kandidatë dhe jo më tepër se 10 kandidatë për 5 vende që do të ketë ky komision i pavarur.

Zonja Bushka, një vlerësim për meritën e kandidatëve dhe përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore. Fjala është për ju.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti kryetar!

Në vijim të procedurës së ndjekur nga Komisioni i Ligjeve rezulton se të 9 kandidatët, të cilët kanë shprehur interesin për të qenë pjesë e Komisionit të Pavarur të Monitorimit të ngritjes së institucioneve të reja të drejtësisë plotësojnë kriteret formale ligjore. Nuk vihet re ndonjë pengesë formale procedurale apo substanciale për të penguar vijimin e këtyre kandidaturave me procesin e përzgjedhjes së tyre, sipas procedurave të përcaktuara në vendimin e Kuvendit nr. 74/2018.

Të 9 kandidatët: Andi Murataj, Artan Spahiu, Gëzim Allaraj, Ilir Kadiu, Irena Nino, Lindita Rusmajli, Sajmir Shehri, Sajmir Vishaj dhe Suzana Pasha Hoti, në kuptimin formal procedural, i plotësojnë kriteret e përcaktuara në vendimin e Kuvendit nr. 74/2018 dhe në relacion jepet një pasqyrë e plotë për të gjithë kandidatët në lidhje me detajet e plotësimit të kriterëve ligjore që përcakton vendimi i Kuvendit nga secili prej tyre. Këtë relacion e keni përpara. Duke iu referuar procedurës që përcakton vendimi i Kuvendit ne na duhet që të 9 kandidatët t’i votojmë me radhë, nominalisht, dhe më pas relacioni së bashku me listën e

kandidatëve të votuar ta paraqesim në seancë plenare të Kuvendit për vijimin e procedurave dhe për mbështetjen e tyre duhet që Kuvendi të shprehet me votë.

Si rregull, ne duhet të kalojmë jo më pak se 7 kandidatë. Pra, lista jonë nuk duhet të ketë më pak se 7 kandidatë. Kështu që ia vë në dukje këtë kolegëve në mënyrë që gjithsekush nga ne të ketë idenë e bërjes së kësaj procedure në formë sa më të rregullt, në mënyrë që ne të kemi mundësinë që t'ia kalojmë relacionin dhe listën, siç e parashikon vendimi i Kuvendit, seancës plenare. Në rast të kundërt, në rast se nuk kalojmë një listë prej 7 emrash, do të na duhet të rihapim garën. Nëse keni ndonjë çështje në lidhje me relacionin, unë jam e hapur për pyetje nga kolegët.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Bushka!

A ka nga kolegët sugjerime apo komente në lidhje me sa parashitri relatorja? Nuk ka.

Në fakt, pjesë e vlerësimit të meritës së kandidatëve dhe përmbushjeve dhe të kriterëve të secilit prej kandidatëve është edhe seanca dëgjimore që ne patëm me kandidatët. Ndaj, zonja relatore, do t'ju lutesha që në raportin që do të përpilohet për seancën plenare të evidentohen qartësisht që në vlerësimin e meritës dhe të kandidatëve të jetë edhe performanca e secilit nga kandidatëve në seancën dëgjimore që u bë në Komisionin e Ligjeve. Gjithsesi, unë do t'i hedh në votim me radhë, sipas renditjes që është bërë.

Vazhdojmë me kandidatin e parë .

Urdhëroni, zoti Fino!

Bashkim Fino – Këta do t'i marrin firmat e deputetëve?

Ulsi Manja – Jo, do të votohen në seancë

Bashkim Fino – Jo, sepse dëgjova se çdo kandidatë do të ketë firmat e deputetëve.

Ulsi Manja – Jo, do të votohen nominalisht në seancë plenare me votim.

Urdhëroni!

Alket Hyseni – Jam dakord me çfarë u tha deri tani, por me një rezervë të vogël. Unë gjykoj se ky komision është shumë i rëndësishëm. Kriteret formale procedurale konstatohen që janë të pranuar. Ne mund t'ia kalojmë Kuvendit, duke ia shtruar për diskutim, por mendoj se jo të gjithë kandidatë janë në lartësinë e duhur të kësaj reforme të madhe. Megjithatë, të mos e vlerësojmë ne këtu, sepse tek e fundit ne jemi teknikien e shikojmë vetëm kriteret formale procedurale. Prandaj le t'ia kalojmë Kuvendit. Nëse Kuvendi do të gjykojë se mund të vazhdojë me të gjithë emrat, është detyrë e tij.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Hyseni!

Kjo që ju thoni është e vërtetë. Prandaj këmbëngula fort që në raportin që do t'i përcillet seancës dhe kolegëve deputetë, të evidentohet gjithçka që ka të bëjë me kandidatët. Ne jemi

komision që bëjmë vlerësimin e kushteve dhe kriterëve ligjore, por edhe të meritës, por në finale vendimmarrja u takon secilit nga kolegët deputetë. Kështu që, jam dakord edhe me ato rezerva që ju shprehni për nivelin e kandidatëve dhe lartësinë e përmbushjes së detyrës nga ana e tyre.

E hedhim në votim kandidatin e parë Andi murataj.

A jeni dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet që t'i kalojë seancës.

Artan Spahiu.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet që t'i kalojë seancës.

Gëzim Allaraj.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Ilir Kadiu.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Irena Nino.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Lindita Rusmajli.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Sajmir Shehri.

Kush është dakord? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Sajmir Vishaj.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Suzana Pasha Hoti. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? 2 abstenim.

Miratohet.

Pra, pas këtij votimi, relatorja dhe këshilltarja e komisionit, që ka punuar me dosjet e kandidatëve, të bëjnë gati raportin për seancën dhe lista me 9 kandidatë do t'i përcillet seancës

plenare për votim. Më pas është në sovranitetin e Kuvendit për të përzgjedhur 5 kandidatët që do të jenë pjesë e këtij komisioni ose jo. Pra, është në çmimin e lirë të Kuvendit për të bërë

zgjedhjen e duhur.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.09.2018, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar (OFID), për projektin e punimeve për riparime emergjente të autostradës Tiranë – Elbasan”. *(Komision për dhënie mendimi)*

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Alket Hyseni, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina dhe Xhemal Qefalia.

Mungojnë:

Enkelejd Alibeaj, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi Tyli, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Tom Doshi dhe Silva Caka.

Të ftuar:

Damian Gjikhuri - Ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Gledian Llatja - Drejtor i Kabinetit në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Afrim Qendro - Drejtor i Përgjithshëm i ARRSH -së

Dardan Malaj - Këshilltar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Enea Karakaçi - Drejtor Juridik në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Erjon Luci - Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Tedi Bushaj - Specialist në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Ulsi Manja - Në fakt, në pikën e katërt të rendit të ditës kemi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar (OFID), për projektin e punimeve për riparime emergjente të autostradës Tiranë–Elbasan”. Komisioni i Ligjeve është komision për dhënie mendimi. Duke qenë se marrëveshja ka një rëndësi të posaçme dhe ka konfirmuar pjesëmarrjen vetë ministri i Infrastrukturës dhe Energjetikës, zoti Gjiknuri, i cili aktualisht është në komisionin tjetër duke prezantuar këtë projektligj, unë kërkoj pak pushim, që t’i krijojmë mundësinë ministrit Gjiknuri për të marrë pjesë në Komisionin e Ligjeve. Mbledhjen e rifillojmë në orën 12:00.

(Rifillon mbledhja)

Rifillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve me pikën e katërt dhe të fundit të rendit të ditës, pra me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar (OFID), për projektin e punimeve për riparime emergjente të autostradës Tiranë–Elbasan”. Komisioni i ynë është komision për dhënie mendimi dhe relator është kolegu Adnor Shamenti. Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, zoti Damian Gjiknuri dhe stafi i ministrisë. Kurse nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë është zoti Erjon Luci zëvendësministër, të cilëve ju uroj mirëseardhjen!

Ju lutem, na bëni një prezantim të kësaj marrëveshje huaje për kolegët e Komisionit të Ligjeve.

Fjala është për ju

Damian Gjiknuri – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë, siç paraqitet edhe në relacionin që keni përpara, kjo është një kërkesë për një shtesë kredie nga një nga anëtarët e sindikatës së huadhënësve për qeverinë shqiptare, të cilët kanë qenë pjesë e këtij projekti që në krye të herës. Bëhet fjalë për një vlerë prej 16 milionë dollarësh, e cila është e mjaftueshme për adresimin e të gjitha problematikave të krijuara gjatë zbatimit të kësaj kontrate dhe për përfundimin e punimeve të mbetura. Kjo vlerë prej 16 milionë dollarësh do të shërbejë për përfundimin e të gjithë segmentit të parë, që është nga Iba deri në tunelin e Elbasanit.

Për të dhënë një rezymë të ecurisë së kontratës, dua të them se kjo kontratë ka qenë e parashikuar të mbaronte me një vlerë prej 312 milionë dollarësh, por, fatkeqësisht, kostoja finale e kësaj kontrate po shkon 450 milionë dollarë, për shkak të problematikave të hasura dhe problemeve të menaxhimit, të cilat ju i dini, sepse janë bërë publike. Pas një pune të

specializuar të institucioneve audituese të qeverisë, ka edhe një kallëzim penal dhe ka një hetim nga prokuroria për këtë çështje, të cilën nuk më takon mua ta komentoj, por shpresoj se do të dalin përgjegjësitë që do t'i vlejnjë të ardhmes për të nxjerrë mësim për këto projekte, të cilat janë madhore, por që fatkeqësisht kanë kushtuar shumë më tepër para sesa janë menduar më parë.

Mendoj se me vënien në dispozicion menjëherë të këtij fondi Autoriteti Rrugor do të jetë në gjendje që të ushtrojë edhe trysinë e nevojshme për zbatimin e kontratës në kohë dhe besoj se brenda këtij viti kjo rrugë do të jetë e hapur dhe e kalueshme drejt tunelit të Elbasanit. Mund të ngelet tek-tuk ndonjë problematikë e vogël, sinjalistikë apo gjëra që mund të marrin pak më shumë kohë, kjo edhe në varësi të kushteve atmosferike, por mendoj se paratë janë të mjaftueshme dhe koha është e mjaftueshme që kontrata të përfundojë në kohë.

Ne bëmë një kërkesë te Komisioni i Ekonomisë dhe Financave që kjo marrëveshje të hyjë në fuqi menjëherë pas publikimit në Fletoren Zyrtare, në mënyrë që këto para të jenë të vlefshme dhe të përfitojmë nga koha e mirë pa shira që të punohet në mënyrë intensive dhe masive. Kjo do të vlejë për mbarimin në kohë të veprës, sepse, nëse do të kemi të papritura të motit, punimet mund të vonohen.

Kredia është e butë me terma afatgjatë, me një *grace periode* 5-vjeçar dhe hyn në ato kredi financiare, të cilat janë të preferuara për qeverinë shqiptare për të adresuar nevoja për investime publike.

Kjo është marrëveshja. Në qoftë se kanë pyetje, do t'u përgjigjem deputetëve.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Gjiknuri!

Përfaqësuesit e Ministrisë së Financave e kanë fjalën

Erjon Luçi – Pak a shumë e ezauroi ministri.

Ulsi Manja – Dakord, është ezauruar me shpjegimin e zotit Gjiknuri. Fjalën e ka relatori, zoti Shameti.

Adnor Shameti – Faleminderit, zoti kryetar!

Duke shfrytëzuar rastin që ministrin Gjiknuri e kishim prezent edhe në Komisionin e Politikës së Jashtme, ku u shqyrtua dhe marrëveshja që është sjellë për miratim në Komisionin e Ligjeve, shpreh mbështetjen e plotë lidhur me këtë nismë ligjvënëse që po shqyrtojmë. Lajmi i mirë për opinionin publik është që me miratimin e kësaj marrëveshjeje në fund të vitit do të përfundojë 100% rruga Tiranë-Elbasan. Në këto kushte, duke qenë se marrëveshja vjen në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar, ftoj anëtarët e komisionit ta miratojmë njëzëri.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Shameti!

A ka pyetje nga kolegët? Po, zonja Xhina.

Elena Xhina – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë personalisht dua ta falënderoj ministrin për këtë nismë dhe për këtë marrëveshje që ka ardhur në komision. Rruga ka kaq kohë që ka problematika dhe është bërë me të vërtetë shkak për problematika edhe për qytetin e Elbasanit dhe për qytetarët që udhëtojnë drejt Tiranës.

Kam një pyetje lidhur me marrëveshjen. A janë rishikuar këto problematika nga ana juaj që të mos përsëriten, siç është fenomeni gjeologjik i rrëshqitjes së dheut, që mund të sjellë të njëjtat pasoja për ndalimin e qarkullimit apo për më tepër për të rrezikuar jetën e personave që udhëtojnë me automjete?

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Xhina!

Zoti Ministër, fjala për ju!

Damian Gjikhuri- Siç e thashë edhe më parë, këto fonde dhe analiza e zbatimit të projektit bëjnë të mundur realizimin e veprës në kushtet siç është, që do të thotë se nëse do të jemi në këto kushte dhe me të dhënat që kemi, vepra do të përfundojë në kohë dhe siç duhet, pa nevoja për financime shtesë, përveçse, dua ta theksoj këtë, nëse ka ngjarje të jashtëzakonshme, ato që quhen forca madhore: rrëshqitje masive, tërmete apo fenomene të tjera gjeologjike, që janë jashtë përmasave normale. Këto janë ngjarje të jashtëzakonshme, të cilat nuk mund t'i parashikojë asnjëri. Në kushte normale kjo vepër do të përfundojë me fondet e parashikuara dhe në kushtet e projektit siç është.

Ulsi Manja- Faleminderit!

Po, zonja Hysi,

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti Ministër!

Pak kohë më parë, në këtë komision ne kemi pasur përfaqësues të ministrisë, që ju drejtoni sot dhe kemi shtruar të njëjtën pyetje lidhur me studimin e fizibilitetit dhe me zgjedhjen që është bërë.

Në vijim të pyetjes që bëri kolegja Xhina, nëse ka ndonjë studim lidhur me rrugën, do të ketë ndonjë spostim apo do të zhvillojë punime në të njëjtat akse dhe në të njëjtat gjurmë që është rruga aktuale?

Pyetja e dytë. Cili është autoriteti që do të supervizojë punimet?

Pyetja e tretë. Me këtë hua që jepet, a mendoni se rruga nuk do të ketë më nevojë dhe ju nuk do të vini të kërkonit fonde në të ardhmen për të bërë të njëjtat punime, jo për mirëmbajtjen?

Faleminderit!

Damian Gjiknuri – Unë iu përgjigja pyetjes pak më parë, por po e përsëris edhe një herë. Gjurma ekzistuese është dhe do të vazhdojmë punimet në këtë shtrat rruge, nuk ka ndonjë ndryshim.

Së dyti, për sa i përket supervizimit, ai bëhet nga inxhinierë të pavarur nga një kompani konsulence dhe një pjesë e këtyre fondeve, të cilat do të miratohen sot këtu dhe nesër në Kuvend, është për shërbim konsulence, me rreth 996 mijë dollarë, të cilat shkojnë për mbikëqyrjen e punimeve të veprës, një element shumë i rëndësishëm, që, fatkeqësisht, nganjëherë i neglizhuar në Shqipëri.

Së treti, nisur nga analiza e projektit, në kushtet që jemi, këto fonde janë të mjaftueshme për të mbaruar veprën, përveç fenomeneve, të cilat janë ngjarje të jashtëzakonshme, siç janë lëvizjet tektonike, gjeologjike, që nuk i di njeri, se janë punët e Zotit.

Ulsi Manja – Punët e Zotit, por në momentin kur u bë studimi i fizibilitetit të asaj rruge, e kam fjalën për qeverisjen që ishte, nuk u morën në konsideratë studimet tektonike dhe gjeologjike.

Në legjislaturën e shkuar, po në këtë komision, kemi dhënë votën për para pa fund për atë rrugë, që me sa duket edhe sot thuhet që...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Fino, keni pyetje?

Bashkim Fino – Po, kam një pyetje, pasi dua të jem korrekt, por e kam nga pjesa e financës më shumë sesa nga ajo e rrugëve, sepse kjo që marrim është një kredi. Në relacion thuhet se shërbimet e konsulencës janë parashikuar 1 milionë e 100 mijë dollarë për periudhën kohore deri në dhjetor të vitit 2018, dhe ministri sapo na tha që në qoftë se e kalojmë në parlament, që të hyjë në fuqi menjëherë, i jepet mundësia firmës të fillojë punë sa më shpejt, pavarësisht se unë nuk kam shumë besim se do të na mbajë koha, pasi tani fillon vjeshta, do të ketë shi dhe mund të jetë me probleme deri në fund të dhjetorit, por në këtë relacion thuhet se kjo konsulencë do të marrë 1 milionë e 100 mijë lekë plus dhe 40 mijë dollarë të tjerë, që janë parashikuar fond për projektin e menaxhimit, që duhen shpenzime, që do të thotë se janë 1 milionë e 140 mijë dollarë, nga 16 milionë që do të votojmë në parlament. Kjo shumë, e cila parashikohet të merret deri në fund të vitit 2018, natyrisht që është llogaritur dhe është në rregull, por problemi dhe pyetja ime është: nëse për shkak të shirave, që tha edhe ministri se

mund të ketë probleme dhe nuk mbaron në vitin 2018, shërbimet e konsulencës a do të kërkojnë fonde të tjera, pas vitit 2019, për këtë punë që po bëjnë? A do të marrim kredi tjetër apo do ta mbyllim me këtë shumë që është këtu, në mënyrë që të mos kemi më probleme?

Të gjithë kalojmë nga rruga e Elbasanit, e cila është e bllokuar dhe të gjithë bëjmë të njëjtën pyetje, se si ka mundësi që rruga nga Iba deri te futja në tunel ka kaq vite pa u bërë, që po të ishte bërë, Elbasani do të quhej lagje e Tiranës. Me këtë kredi që ne marrim duhet të na jepet garancia e vërtetë që kjo rrugë do të mbarojë dhe do të funksionojë normalisht. Ky është lajmi më i mirë dhe më interesant.

Faleminderit, kryetar!

Ulsi Manja- Zoti Gjiknuri!

Damiani Gjiknuri – Jam dakord me ju dhe ky është lajmi kryesor. Për këtë jemi këtu, që ta përfundojmë njëherë e mirë këtë sagë, gangrenë të mbartur dhe këtë rrugë jashtëzakonisht të rëndësishme për lidhjen me jugun e vendit.

Për sa i përket pyetjes suaj lidhur me konsulencën, që është parashikuar 996 mijë dollarë, te kjo kredi po miratojmë edhe 1,5 milionë dollarë fond rezervë për çdolloj të papriture, ku normalisht do të përfshijmë dhe ndonjë shtesë të vogël për sa i përket konsulencës. Pra kjo kredi ka rreth 13,4 milionë punime civile dhe 1,5 fond kontingjence...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, janë fonde.

Ulsi Manja- Faleminderit, zoti Gjiknuri!

Zoti Hyseni, fjala për ju!

Alket Hyseni –Zoti Ministër, meqë ju kemi në komision sot shfrytëzoj rastin t'ju komplimentoj që më në fund po i jepni zgjidhje kësaj gangrene të madhe prej vitesh. Ato zullume, që bënë të tjerët shumë kohë më parë, tashmë na kanë ngelur detyrë neve t'i zgjidhim dhe t'u japim fund. Meqenëse ju dhe drejtori i ARSH-së jeni sot këtu dua, të di lidhur me procedurat për rrugën Kardhiq-Delvinë, meqë jam deputet i zonës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Fino, le të kenë mediat dy lajme të mira, një për zgjidhjen e rrugës së Elbasanit dhe një për rrugën Kardhiq-Delvinë.

Ulsi Manja- Zoti Hyseni, faleminderit për pyetjen, por është jashtë rendit të ditës, aq më tepër që ju dhe ministri jeni në konflikt interesi, sepse jeni të dy deputetë të zonës. Kështu që, kur të mbliidhemi për të diskutuar për rrugën Kardhiq-Delvinë..

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Përsëri jeni jashtë rendit të ditës, por unë e lë në zgjedhjen e ministrit nëse do t'i përgjigjet ose jo kësaj pyetje.

Damian Gjikhuri- Të gjitha projektet, për të cilat ne kemi deklaruar se do t'i mbyllim kontratat këtë vit, qeveria shqiptare do t'i bëjë realitet. Pra, segmentet e reja, përfshirë edhe ato gangrenat e mbartura dhe bajpaset...

Ulsi Manja- Përfshirë edhe Rrugën e Arbërit.

Damian Gjikhuri – Rruga e Arbërit ka filluar tashmë. Kështu që të gjitha projektet e nisura do të realizohen nga pikëpamja e procedurave dhe e lidhjes së kontratave në kohë, pastaj mbetet zbatimi i tyre.

Ulsi Manja –Faleminderit, zoti Gjikhuri!

Hedhim në votim në parim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe fondit OPEC për zhvillim ndërkombëtar (OFID), për projektin e punimeve për riparime emergjente të autostradës Tiranë-Elbasan”.

Kush është dakord në parim? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet në parim.

Kalojmë te neni 1. Kush është dakord? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Hedhim në votim në tërësi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe fondit OPEC për zhvillim ndërkombëtar (OFID), për projektin e punimeve për riparime emergjente të autostradës Tiranë-Elbasan”

Kush është dakord? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Me këtë çështje dhe me kërkesën që shprehu ministri Gjikhuri, për hyrjen menjëherë në fuqi të marrëveshjes, edhe ne, si komision, bashkohemi me mendimin e Komisionit të Ekonomisë. Raporti së bashku me projektligjin do t'i përcillen komisionit përgjegjës dhe më pas seancës plenare për votim.

Këtu e mbyllim mbledhjen e komisionit të ditës së sotme. Mbledhja e radhës, së bashku me rendin e ditës do t'ju njoftohet nëpërmjet sekretarisë së komisionit.

Faleminderit, zoti Gjikhuri dhe zoti Luçi!

Ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA